



qendra e provimeve

SHIFRA E NXËNËSIT

PROVIMI I MATURËS

JANAR 2018

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

U D H Ë Z I M

KOHA PËR ZGJIDHJE TË TESTIT ËSHTË 180 MINUTA

Gjatë testit nuk lejohet përdorimi i pajisjeve elektronike.
Nxënësi/nxënësja nuk guxon në asnjë mënyrë ta zbulojë identitetin e vet në test ose t'i drejtohet vlerësuesit në mënyrë të drejtpërdrejtë.
Testi **DUHET** të zhvillohet me laps kimik i cili nuk mund të fshihet.

Testi përmban detyra në të cilat do të përgjigjeni në njërin prej këtyre mënyrave:

- duke rrethuar numrin para përgjigjes së saktë
- duke shkruar një përgjigje të shkurtër
- duke shkruar një përgjigje më të gjatë
- duke shkruar ese

Me testin ke marrë edhe **fletën e përgjigjeve** për detyrat me zgjedhje të shumëfishtë.

Nevojitet që në vendin përkatës me kujdes t'i përshkruash përgjigjet tua.

Detyra do të vlerësohet me (0) pikë nëse:

- është e pasaktë
- janë rrethuar më shumë përgjigje të ofruara
- është e palexueshme dhe e paqartë
- zgjidhja është shkruar me laps të thjeshtë

Nëse gabon vendos një vijë të kryqëzuar mbi të dhe detyrën zgjidhe përsëri. Kur ta përfundosh zgjidhjen e testit, kontrolloji edhe njëherë përgjigjet tuaja. Me fat!

Me fat!



A 8 2 8 8 6 *

FAQE E ZBRAZËT

KUJTESA MË E MIRË

Mënyra më e mirë që të mbahet mend vjersha e posa mësuar, zgjidhja e detyrës nga matematika ose ndonjë mjeshtri e re me letra është që pas mësimit të bëhet një gjumë i shkurtër, pohojnë shkencëtarët gjermanë. Studiuesit kanë provuar se truri gjatë gjumit është shumë më rezistent ndaj “prishjes” së informacioneve të freskëta, kështu që studimi i tyre hedh një dritë të re mbi procesin jashtëzakonisht të kompleks me të cilin njerëzit ruajnë dhe përdorin informacione dhe të dhëna të fituara qëllimisht, transmeton Radio “Dojçe Vele”.

Hulumtimet e mëhershme kanë treguar se informacionet e freskëta, të ruajtura përkohësisht në një pjesë të trurit të quajtur hipokampus, nuk „pranohen“ menjëherë. Dihet gjithashtu se riaktivizimi i këtyre informacioneve pak pas të mësuarit, ka një rol kyç në vendosjen e tyre të përhershme në neokorteks, “hard diskun” e trurit. Në një gjendje të zgjuar, një kujtim i shpejtë i një të mësuarit është zakonisht një proces i pasigurt. Sikur, për shembull, kënga e dytë do të mësohej pak pas të parës, ky veprim sipas të gjitha gjasave do ta vështirësonte vendosjen e të parës në memorien e thellë.

Bjorn Rash nga Universiteti i Libekut dhe kolegët e tij supozonin se e njëjta gjë ndodh edhe në gjumë dhe kanë bërë një hulumtim për të parë nëse ata kishin të drejtë. Në test janë lutur 24 vullnetarë që të provojnë të mbajnë mend 15 palë të letrave me figura, në mënyrë që pas 40 minutave gjysma e të anketuarve shkuan për të fjetur, kurse të tjerët kanë fituar 15 palë të reja të letrave me një model pak më ndryshe të figurave. Pas një sy gjumi edhe grupi i parë ka marrë të njëjtën detyrë, pas së cilës anëtarët e të dy grupeve është dashur të tregojnë çfarë kanë mbajtur mend nga detyra origjinale.

Për befasi të shkencëtarëve, grupi që kishte fjetur arriti rezultate shumë më të mira, duke çiftëzuar saktësisht 85 për qind të letrave, kundrejt 60 për qind të grupit i cili kishte qenë i zgjuar.

„Riaktivizimi i kujtesës kishte një efekt krejtësisht të ndryshëm në kohën derisa personat ishin të zgjuar dhe në gjumë“, tha dr. Suzan Dikelman duke shtuar se në bazë të CT incizimeve mund të supozohet se arsyeja për këtë rezultat befasues është fakti që në minutat e para të gjumit filloi përcjellja e të dhënave nga hipokampusi në neokorteks.

(Përgatitur nga burimi http://relaksuar.rs/jeta_e_shendetshme, 6 shkurt, 2011)

- 1.** Kush e ka përcjellë informacionin e hulumtimit të shkencëtarëve për mënyrën e ruajtjes së përhershme të dhënave në tru?

1 pikë

- 2.** Çfarë duhet bërë që të mbahet mend më mirë informacioni?

1. Të shkohet për të fjetur.
2. Të vazhdohet menjëherë me mësimin e leksionit të ri.
3. Të provohet të mbahen mend 15 palë letra me figura.

Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve.

1 pikë

- 3.** Duke u bazuar në tekst shkruaje çfarë është “hard disku” i trurit?

1 pikë

- 4.** Çfarë ishte supozimi i Bjorn Rashit nga Universiteti i Libekut dhe kolegëve të tij?

1 pikë

- 5.** A) Cilat rezultate të hulumtimit i befasuan shkencëtarët?

1. Riaktivizimi i kujtesës është më i mirë në gjendje të zgjuar.
2. Riaktivizimi i kujtesës është i njëjtë në gjendje të zgjuar dhe në gjumë..
3. Riaktivizimi i kujtesës është ndryshe në gjendje të zgjuar sesa në gjumë.

Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve. 1 pikë

B) Shpjegoje përgjigjen.

1 pikë

Lexoje tekstin dhe përgjigju në detyrat 6, 7, 8, 9 dhe 10.

Veprën *Testamenti francez* (1995) e karakterizon qartësia stilistike dhe mënyra e thjeshtë e rrëfimit. Pa hidhërim dhe qortim shkrimtari flet, por nuk gjykon dhe nuk jep vendime. Për këtë roman Andrej Makin ka marrë shpërblimet *Gonkur* dhe *Medisis*. Romanet e tij të parë *Vajzat e heroit të Bashkimit Sovjetik*, *Rrëfimi i flamurtarit mëkatar*, *Derisa rrjedh Amuri* nuk kanë rënë gjithaq në sy dhe nuk i kanë sjellë famë dhe para. Pas fitimit të shpërblimit publikon romanin *Krimi i Ollga Arbeljinës*, *Rekuiem për Lindje*, *Muzika e një jete* (2001) për të cilin fiton shpërblimin prestigjioz *RTL Lyrën* në sallonin e librit në Paris.

Andrej Makin (1957) ka lindur në Krasnojarsk, në Siberi. Gjyshja e tij Charlota, franceze e ka arsimuar në frymën e gjuhës dhe kulturës frënge, por duke mos lënë pas dore as kulturën ruse. Gërshetimi i dy kulturave i ka ndihmuar që të kuptojë që rezistenca e brendshme gjithmonë është e mundshme duke falënderuar botët e ndryshme në të cilat jetojmë. Ka përfunduar shkencat filologjike në Universitetin e Moskës më 1987 dhe duke e falënderuar programin e shkëmbimit të profesorëve shkon në Paris. Ka ligjëruar disa vjet gjuhën ruse dhe letërsinë, kurse në Universitetin Parisi IV ka mbrojtur doktoraturën për veprën e shkrimtarit të madh rus Ivan Bunjin. Tani ky shkrimtar i njohur dhe i pranuar jeton në Paris.

6. Paragrafi i dytë i tekstit është:

1. rekomandim për leximin e romanit *Testamenti francez*
2. biografi e shkrimtarit të njohur Andrej Makin
3. tregim për rëndësinë e veprës së Ivan Bunjin

Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve. 1 pikë

7. Përse është me rëndësi për Andrej Makin viti 1995?

1 pikë

8. A) Shpërblimin e RTL Lyrës në sallonin e librit në Paris e fiton për:

1. një roman
2. dy romane
3. tre romane

Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve. 1 pikë

B) Argumentoje përgjigjen.

1 pikë

9. Në bazë të tekstit shkruaje:

1. vendin e fëmijërisë së shkrimtarit _____
2. vendin ku e ka përfunduar fakultetin _____
3. vendin në të cilin jeton _____

1 pikë

10. Për veprën *Testamenti francez* mund të themi se është një best-seller.

Shpjegoje fjalën best-seller.

1 pikë

11. A) Rrethoje numrin para vitit të shkruar saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve.

1. Andrej Makin 1957. ka lindur në Krasnojarsk
2. Andrej Makin (1957) ka lindur në Krasnojarsk
3. Andrej Makin (1957.) ka lindur në Krasnojarsk

1 pikë

B) Argumentoje përgjigjen.

1 pikë

12. Shkruaje shkronjën që mungon (ç, sh ose zh) në mënyrë që fjala të shkruhet saktë.

i përdit____ëm ____duk i përshtat____ëm

vaj____a ____gardhoj ____gradim

2 pikë

Lexo vjershën „Nata” nga poema „Kush i pari bani” dhe përgjigju në pyetjet 13, 14, 15, 16 dhe 17.

Lugut t'qiellit fluturojnë retë hijeranda
vedrat e territ tue derdhë mbi rrugët e
 plasarituna-
Nata e erret horizontet i mbylli...
Qiella tash bahet si çerep'i zi...
Dhe pikat e para t'shiut
hovshëm lëshohen mbi rrugë e pullaze.
...Diku, nji za i pikluem, si ai i nanës
 mbi kufomën e birit t'vetëm;
thirrje e prekshme e dikujt, si ofshamë,
 n' shushurimën e errët t'shiut-
si klithje e fëmisë t'humbun në furtunë...
Bie me rrëshak...Shiu end
pej t'panumërt...Bie pika si plumbi,
si kazmat e randa t'punterëve...
-O, si me dashtë me shembë çdo gja në këtë
 natë t'merrshme!
Kujisin thithat e ndryshkuna në kapakët e dritareve
 ku me hov sulmon shiu,
frushkullon erë e furishme...
Lebetisin kunorat e pemëve, ulurojnë me za
 vajtues...
E drita e zbehtë dridhet në dhomëzën e errët plot
 myk,
ku gurbetqarët t'rrasun fishek, nder skuta ku nuk

pikon,
andrhojnë shtretnit e ngroftë, trupat e lodhun
me i çlodhë...
Era tërbueshëm uluron mbi pullazet e çame
t'shtëpive,
dridhen trupat e ngrime nën leckat e mbulojës në
skutat e errëta t'dhomës,
në vorr për s'gjalli – te dënuem për shfarosje...
Ferri i kësaj bote dorën ua shtrin t'mjerëve
para se me hy ne parajsën e jetës s'amshueme!

Esad Mekuli

13. Për çfarë shquhet poema nga e cila është veçuar kjo poezi?

2 pikë

14. Kjo poezi ashtu si edhe poema dhe krijimet tjera të Mekulit ka mjaft afri me krijimet e:

1. Bulkës
2. Migjenit
3. Çajupit
4. Xanonit

Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve. 1 pikë

15. Në këtë poezi autori përdor vargun e lirë.

PO

JO

Rretho përgjigjen e saktë (PO ose JO) dhe argumentoje atë.

1 pikë

16. Në fillim të kësaj vjershe autori shprehet: *Lugut t'qiellit fluturojnë retë hijerënda/ vedrat e territ tue derdhë mbi rrugët e/ plasarituna-*. **Çfarë paraqet Mekuli me këto vargje?**

1 pikë

17. ...*Era tërbueshëm uluron mbi pullazet e çame/ t'shtëpive, /dridhen trupat e ngrime nën leckat e mbulojës në/ skutat e errëta t'dhomës,*

A) Motivet e dhëna poeti i:

1. trillon nga imagjinata e tij
2. merr nga poezia popullore
3. gjen në mjedisin e tij

Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve. 1 pikë

B) Çfarë figure stilistike përdor Mekuli në fjalët e nënvizuara?

1 pikë

Lexoje fragmentin në vijim dhe përgjigju në pyetjet 18, 19, 20, 21, 22 dhe 23.

- Sa i ka pëlqyer shokut Q raporti i Zylos! Shiko si buzëqesh shoku Q, - tha Adila duke bërë me kokë nga presidiumi. – Ama i tha Zylos që kur ia lexoi raportin: “kam ndier kënaqësi duke e lexuar. Bravo! Do të na nderosh”!

- Ashtu është, - thashë dhe u përpoqa ta hedh mendjen diku jashtë sallës për të mos e dëgjuar këtë llafazane. Por ajo nuk pushonte.

- E ke lexuar ti raportin e Zylos, apo e dëgjon për herë të parë? – më pyeti Adila.

Unë e humba durimin.

- E kam lexuar më përpara se shoku Zylo, - thashë.

Ajo shtangu një herë. Pastaj iu dha të qeshurit.

- Qenke shakaxhi, Demkë!

- Jam pak shakaxhi, - thashë unë.

Ndërkohë, përsëri në sallë rrahën shuplakat. Shoku Zylo mblodhi fletët e raportit dhe u largua nga mikrofoni. Ai i dha fund fjalës së tij.

Pasdite do të fillonin diskutimet.

Ne me gruan e shokut Zylo dolëm nga salla. Në korridoret e pallatit ku bëhej mbledhja, njerëzit e takonin shokun Zylo dhe i shtrëngonin dorën:

- Na pëlqeu shumë raporti, shoku Zylo!...
- I shkëlqyer!...
- Probleme të mëdha!...

Nga shkallët e mëdha zbrisnin shkrimtari Adem Adashi me të shoqen, një grua e hijshme me një fytyrë të zeshkët, të lëmuar, të bukur. Qafa e saj ishte e gjatë me një nishan të vogël në anë. Ata na vunë re mua me Adilën dhe u afruan. Kleopatra buzëqeshi dhe ia zgjati dorën në fillim Adilës, pastaj mua. Nga gëzimi ajo mezi përmbahej. Padashka përplaste edhe shuplakat e saj të vogla.

18. A) Shkruaje titullin e veprës nga e cila është marr fragmenti i dhënë.

_____ *1 pikë*

B) Kush është autor i veprës?

_____ *1 pikë*

19. A) Rrethoje numrin para llojit të romanit të cilit i takon kjo vepër.

1. Roman historik
2. Roman psikologjik
3. Roman satirik

1 pikë

B) Argumentoje përgjigjen.

_____ *1 pikë*

20. Cilat forma të shprehjes artistike i dallon në këtë fragment?

_____ *1 pikë*

21. A) Personazhi kryesor i veprës është:

1. Demka
2. Shemshedini
3. Zyko Kamberi

Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve. 1 pikë

B) Pse konsiderohet i tillë?

1 pikë

22. Çfarë raporti ka ndërmjet titullit dhe përmbajtjes?

2 pikë

23. Pozita e vartësit në këtë roman është:

1. e lakmueshme
2. e padurueshme
3. për keqardhje

Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve. 1 pikë

24. Sqaroje domethënien e fjalës *zhezhitet* në fjali *Misri i lagët zhezhitet*.

1 pikë

25. Nga shpallja përshkruaje trajtën e fjalës e cila nuk është përdorur në formën e duhur.

Shes shtëpinë në katin në Ulqin e cila ka 350 m², truallin
500 m². Me leverdi.
Tel. 067.....

1 pikë

26. Në bazë të fragmentit nga vepra shkruaje emrin e veprës dhe autorin e saj.

Por, kjo koha e karnavaleve, meqë prej të parëve tanë ka qenë e caktuar për valle, lojë e gëzime, dhe duke parë se shoqërisë sonë "Pomet" nuk i kalojnë dot karnavalet pa ndonjë festë, o të bukur, o trashamane, vendosëm të shfaqim një komedi, e cila, edhe nëse nuk do të jetë kaq e mirë dhe e bukur, të bukura janë këto gra që do ta shohin dhe të mirë ju, që do ta dëgjoni.

1 pikë

- Shikoni, o të mjerë, të mos i afrohi fort malit Tomorrit, po të vini një shenjë pushke lark rëzësë malit, se mal'i Tomorrit ka hie të rëndë e u shkel, a heth ndonjë koqe rrufeje e u godit ndë majët të kresë, e u depërton tej mb'at' anë, e u vret, e s'u lë pikë gjallë.

1 pikë

Nëpër fusha ku rrjedh Misisipia
Ushtoi rrokull nji za si bubullima;
Krisi ndër male si kërset ushtima
Kur qiell e tokë i turbullon duhia.

Çonju sherbtorët e tokës, lëni te shpia
Shetnit e vangat, e përgjysmë, o trima,
Leni parmendat; rrokni pushkët; vetima
Iu duk për slargu, e që po vjen liria;

1 pikë

27. Në bazë të fragmentit nga vepra letrare shkruaje gjininë letrare dhe llojin letrar që i përket.

Zonja Kapulet:

Turp, turp, mos të la mendja?

Zhulieta:

Baba, të lutem shumë e gjuhëzuar,

Dëgjomë e ki durim të them një fjalë.

Kapuleti:

Oh, shporru moj zuskë! Mistrece e pabindur!

Këtë të bësh, të shkosh në kishë të enjten!

Përndryshe, kurrë mos më dil përpara.

Mos u përgjigj! Pusho! Më hanë duart!

Shporru, cipëplasur!

(gjinia letrare)

(lloji letrar)

2 pikë

28. Në fjalinë e dhënë ka disa gabime. Gjeji ato dhe fjalinë përshkruaje saktët.

Sa për atë kishte pamjen e njeriut që thotë: Pa të shohim si do t'ia bësh tani.

1 pikë

29. “Një muaj ditë bota e kishte përfolur atë ngjarje dhe në biseda e kishte shpërlarë gojën me poshtërimin e ardhshëm të Fatimës si me ujë të ëmbël.”

Në vend të kohës së krye të nënvizuar shkruaje kohën e pakryer.

e kishte përfolur _____

e kishte shpërlarë _____

1 pikë

30.

Janë ofruar dy tema për hartimin e esesë. Rrethoje numrin para temës që do ta zhvillosh. Eseja duhet të përmbajë 250 deri në 300 fjalë.

Hartoje atë si tërësi që duhet të ketë hyrjen, zhvillimin dhe përfundimin. Respekto kërkesën për numrin e fjalëve +/-10% (vlerësohet punimi që ka 225 deri në 330 fjalë; nëse eseja ka më pak se 225 fjalë NUK LEXOHEM FARE, kurse në fjalën e 330-të NDËRPRITET leximi).

Gjatë hartimit të esesë kij kujdes për mënyrën e të shprehurit dhe për zbatimin e normave drejtshkrimore. Shkruaj lexueshëm.

1. Analiza e poezisë *Kroj i fshatit t'onë*

I

Kroj i fshatit t'onë, ujë i kulluar,
Ç' na mburon nga mali dyke mërmëruar.

Venë mbushin ujë vashat an' e mbanë,
Cipëzën me hoja lidhure mënj' anë;

Cipëzën e bardhë, cipëzën e kuqe,
Gushën si zambaku, buzët si burbuqe.

E si mbushin ujë, bubu! ç' m' ju ka hije
Ndaj këthenen prapë me hap nusërije:
Ndezur yll' i ballit si yll shentërije.

II

Kroj i fshatit t'onë, gjyrë 'gjëndi-lyer,
Që nga rrëz' e malit ç' na mburon rrëmbyer.

Venë pijnë ujë trimat an' e mbanë,
Takijen me lule përmi sy mënj' anë.

Takijen e dliërë, takijen e nxirë,
Buzën më të qeshur...më të pëshërëtirë...

Mbrëmave kur uji mërmëron ngadalë,
Vjen t'i thotë trimi vashës nj' a dy fjalë;

Vashëzën bujare që po vij më krua
Seç' e përshëndeta, seç' m' u turpërua

Papu ula kryet e shikova si grua

III

Kroj i fshatit t'onë, tetë sylynjarë,
Nër tetë krahina qënke kroj i parë;

Qënke një në botë, s'paskërke të dytë,
Ç' na shëroke plagët, ç' na shëroke sytë.

Kroj i fshatit t' onë, n' atë mal me fletë,
Derdhet aq i egër, derdhet aq i qetë,
Posi mall' i i zemrës mun në gji të shkretë:

Derdhet aq i egër, derdhet aq i qetë.
Posi mall' i vashës, që djeg më të fshehtë,
Posi mall' i trimit, që buçet përperjetë,
Obobo! si malli, që nuk vdes përjetë.

Udhëzime për shkrimin e esesë Analiza e poezisë *Kroj i fshatit t'onë*.

Shkruaj:


- Kush është autori i poezisë, vendin e zhvillimit të ngjarjes dhe çfarë trajton ajo?
- Në cilën përmbledhje bën pjesë kjo poezi, cilat janë tiparet e kësaj poezie dhe në sa pjesë është e ndarë?
- Për subjektin e poemthit, përshkruaje atë që trajtohet nëpër këto pjesë. Veço ndonjë figurë stilistike që përdor autori dhe thekso notat që e përshkojnë këtë poezi.
- Për vargun që përdor poeti për ta hartuar këtë poezi, cezurën e saj.

2. Si ushqehesh – ashtu mendon, si mendon – ashtu jeton

Udhëzime për shkrimin e esesë.

- Ushqimi i duhur dhe i shëndetshëm është bërë një nga problemet më të rëndësishme të njeriut modern. Kumtoje qëndrimin për këtë konstatim.
- Kumtoje qëndrimin tënd për mënyrën e të ushqyerit të bashkëmoshatarëve tu.
- Sot gjithnjë e më tepërt konsumojmë të ashtuquajturin ushqimin e shpejtë. Cilat janë, sipas mendimit tënd, përparësitë dhe mangësitë e konsumimit të ushqimit të shpejtë.
- Trego për sëmundjet e mundshme që shkaktohen nga mënyra moderne e jetës dhe të ushqyerit.
- Dikur përkujdeseshin për bontonin rreth tryezës. A është me rëndësi bontoni edhe për shoqërinë bashkëkohore. Shpjegoje qëndrimin tënd.
- Disa mendojnë se mënyra e të ushqyerit nuk ndikon në atë nëse njeriu do të jetë i shëndetshëm ose jo, kurse të tjerët thonë se shëndeti varet para së gjithash nga të ushqyerit. Përcaktoju për njërin qëndrim dhe argumentoje atë.

25 pikë



2

2

3

3

4

4

5

5

6

6

7

7

8

8

9

9

10

10

11

11

12

12

13

13

14

14

15

15

0 1 2 3 4 5 6 7 8 9

0 1